



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 51 prot.

Kamëz, më 25.5.2026

V E N D I M
Nr. 44.Datë 25/5 2026
MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”, PËR VITIN 2026”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.05.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.32 Datë 19.05.2026 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 22/2018, “Për Strehimin Social” të ndryshuar; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; Vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKB nr.114 datë 20.11.2024 “Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë”; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.5375 Prot datë 18.05.2026, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së 31 familjeve për të përfutur nga programi Strehimit Social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, për vitin 2026, sipas Tabelës A, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Listën pritëse të 10 familjeve për të përfutur nga programi Strehimit Social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, për vitin 2026, sipas Tabelës B, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Familjet e përcaktuara në Tabelën A të këtij vendimi, duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve pranë institucionit bankar, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz. Mosrespektimi i këtij afati është shkak për skualifikimin e tyre.
4. Mgarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

